



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-034

Prishtinë, më 21 shtator 2015, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 SHTATOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Slavko Simiq, Valdete Bajrami dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE: Floriana Shala,

Nga KDI: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 31 korrik dhe 14 shtator 2015,
2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës plenare.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 31 korrik dhe 14 shtator 2015.

2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancës plenare:

Kryetari kërkoi mendimin e nënkryetarëve të Kuvendit dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare për caktimin e datës dhe të pikave të rendit të ditës për vazhdimin e seancës plenare, të filluar më 17 shtator 2015.

Për këtë pikë diskutuan: Donika Kada-Bujupi, Albulena Haxhiu, Ismet Beqiri, Valdete Bajrami dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të martën, më 22 shtator 2015, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale